



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 42/4 Prot.

Tiranë, më 03.02 2015

VENDIM

Nr. 15, datë 03/02 2015

Bazuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5/b/c të nenit 24. të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, nenin 16 të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, shtetasi ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 1899/2, datë 30.12.2014, me objekt, “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.

Bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ankuesi ka kërkuar nga Autoriteti Publik/Rektori i Universitetit të Tiranës të vendosë në dispozicion të dhëna dhe dokumente zyrtare si, *1) Shkresën nr.723 prot, datë 8.10.2014 të Dekanit të Fakultetit të Shkencave Sociale(FSHS); 2) Kërkesën e Rektorit të Universitetit të Tiranës, drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe përgjigjen e saj sipas shkresës nr.8560/1 prot, datë 14.10.2014; 3) Të informohet se për cilët punonjës të FSHS-së dhe UT-së, përveç tij, Rektori, ka kryer verifikim të hyrje-daljeve nga territori i Republikës së Shqipërisë. Në vijim të kësaj ankese depozitoi një tjetër ankesë me nr. 42/1 Prot, datë 14.01.2015, duke bërë me dije Zyrën e Komisionerit, mbi dokumentacionin të cilën Rektori i Universitetit të Tiranës kishte vënë në dispozicion të tij, nëpërmjet shkresës nr. 3647/2 Prot, datë 6.01.2015 si dhe duke kërkuar pjesën tjetër të dokumentacionit të pa dhënë. Më konkretisht, rezulton se, ankuesi është pajisur me shkresën nr.723 prot, datë 8.10.2014 të Dekanit të Fakultetit të Shkencave Sociale(FSHS) dhe shkresën nr.8560/1 prot, datë 14.10.2014, të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa, parashtron edhe dokumentet të cilat Rektori i Universitetit të Tiranës nuk i ka vënë në dispozicion, *1) Kopje të kërkesës së Rektorit drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme; 2) Kopje të dy raporteve të fundit të auditit të kryer në FSHS nga Rektori (kërkuar me anë të shkresës e cila mban datën 22.12.2014, bashkëlidhur ankesës) si dhe 3) Njoftimin mbi të dhënat e kërkuara në lidhje me verifikime të hyrje-daljeve nga territori i Republikës së Shqipërisë, nga Rektori, për të tjerë punonjës të UT-së.**

Nga shqyrtimi i dosjes, rezulton se, legjitimohet në depozitim e ankesës së tij në përputhje me pikën 2 të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Nga

pretendimet e parashtruara në ankesë dhe provat e administruara në dosje vërehet se, nga Rektorati i Universitetit të Tiranës nuk është përmbushur detyrimi ligjor i parashikuar në pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” për të trajtuar kërkesën e paraqitur nga ankuesi (në cilësinë e kërkuarit ndaj autoritetit publik) brenda afatit kohor 10 ditë pune.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri bazuar në pikën 3 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” me urdhrin nr.11, datë 16.01.2015, nisi inspektimin administrativ pranë këtij autoriteti publik me objekt *“Verifikim mbi ankesën e depozituar pranë Zyrës së Komisionerit nr.1899/2 Prot., datë 30.12.2014 dhe ankesës në vijim nr.42/1 datë 14.01.2015 nga shtetasi [emri i personit], mbi refuzimin e dhënies së informacionit nga ana e Rektoratit të Universitetit të Tiranës”*.

Në përfundim, grupi i inspektimit mbajti procesverbalin përkatës në datë 20.01.2015, në të cilin u pasqyruan konstatimet e inspektimit administrativ. Nga ana e përfaqësuesve të Rektoratit u vendos në dispozicion të inspektorëve shkresa e Rektorit të Universitetit të Tiranës nr.2920/2 prot, datë 13.10.2014 drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe kjo provë u pasqyrua në procesverbal. Sa i përket kërkesës për kopje të dy raporteve të fundit të auditit të kryer në FSHS nga Rektorati, ky i fundit shprehet në procesverbal se do të marrë të gjitha masat për të zbatuar parashikimet e nenit 7 të përcaktuar në ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Në përputhje me përcaktimin e paragrafit të dytë të pikës 2, nenit 16, *“...Kur informacioni nuk kërkohet në format elektronik, autoriteti publik nuk mund t'i përgjigjet kërkesës, duke i treguar kërkuarit adresën e saktë të faqes ku informacioni gjendet në formë elektronike.”*

Nën këtë arsyetim, pavarësisht bërjes publike në faqen zyrtare të autoritetit publik, Komisioneri vlerëson që ky i fundit duhet të trajtojë kërkesën dhe të parashtojë informacionin e kërkuar sipas formatit që përcakton kërkuari për dhënien e dy raporteve të fundit të auditit të kryer në FSHS nga Rektorati i Universitetit të Tiranës, përveç rasteve kur ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit” parashikon ndryshe (në referim të nenit 14 dhe 16 të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”).

Në lidhje me informacionin mbi të dhënat e kërkuara nga Rektorati për verifikimet e hyrjedaljeve nga territori i Republikës së Shqipërisë për të tjerë punonjës të UT-së, autoriteti publik shprehet se vënia në dispozicion e këtij informacioni, i nënshtrohet kufizimeve të përcaktuara në nenin 17/1/a. Më konkretisht, neni 17/1/a specifikon *“1. E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm, a) të drejtën për një jetë private”*. Përfaqësuesit e autoritetit publik kanë deklaruar gjithashtu në procesverbal, se *“...ka paraqitur këto kërkesa pasi i ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me FSHS-në e UT-së, ndërsa çështja ka kaluar në juridiksionin gjyqësor dhe vendimi i formës së prerë do të merret pas shqyrtimit nga organet e drejtësisë. Në shkallën e parë, procesi gjyqësor është fituar nga UT”*.

Ligji për të drejtën e informimit ka parashikuar shprehimisht disa veprime që duhet të kryejë autoriteti publik në rast të marrjes së një kërkesë. Paraprakisht, nëse autoriteti publik disponon informacionin e kërkuar, ai është i detyruar të trajtojë kërkesën brenda 10 ditë pune nga depozitimi i saj, e ndërsa për shkaqe të parashikuara në pikën 3 të nenit 15, të shtyjë trajtimin e saj me 5 ditë pune të tjera, duke e njoftuar menjëherë kërkuarin. Gjithashtu, autoriteti publik gjatë trajtimit të kërkesës detyrohet të vlerësojë dhënien e informacionit për kërkuarin në

përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në të cilin përcaktohet informacioni publik pa kërkesë si dhe me nenin 17 në të cilin përcaktohen rastet e kufizimit të dhënies së informacionit /dokumentacionit.

Shkelja e konstatuar në këtë rast është mos trajtim i kërkesës brenda afateve të përcaktuara, si dhe mos parashtrimi i informacionit të kërkuar. Në përputhje me pikën 4 të nenit 15 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ky veprim konsiderohet “refuzim”.

Ligji ka parashikuar se, ky mosveprim konsiderohet kundërvajtje administrative dhe në përputhje me nenin 18/2/a të tij “a) refuzimi i dhënies së informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë.”.

Në kushte të tilla kur provohet mos trajtimi i kërkesës brenda afatit të parashikuar në ligj, arrihet në përfundim se, ankesa është konform ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe si e tillë ajo duhet pranuar në përputhje me objektin e saj për aq sa e lejon ligji i lartpërmendur.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në pikën 5/b/c/ç të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr.1899/2 Prot., datë 30.12.2014 dhe ankesës në vijim nr.42/1 datë 14.01.2015 të ankuesit _____ kundër Autoritetit publik/Rektoratit të Universitetit të Tiranës.
2. Urdhërimin e Rektoratit të Universitetit të Tiranës të parashtrrojë për ankuesin _____, në përputhje me objektin e kërkesës datë 22.12.2014, dy raportet e fundit të auditit të kryer në Fakultetin e Shkencave Sociale nga Rektorati i Universitetit të Tiranës, brenda datës 13.02.2015.
3. Rrëzimin e ankesës së _____, mbi të dhënat e kërkuara në lidhje me verifikime të hyrje-daljeve nga territori i Republikës së Shqipërisë, për të tjerë punonjës të UT-së.

Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtë të ankohen pranë Gjykatës Administrative në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ky vendim u dha sot në datë 03.02.2015.

